

03. Mosiu, Pashka, Dalja

«Asnjë tundim nuk ju ka gjetur juve, përveç se tundimi njerëzor; por Perëndia është besnik dhe nuk do të lejojë që t'ju tundojnë përtej fuqive tuaja, por me tundimin do t'ju japë dhe rrugë dalje, që ju të mund ta përballoni.» 1 KORINTASVE 10 :13

QELLIMI

Te ecim me besim, duke u mbështetur ne Perendine.

HYRJA

Jakobi, nipi i Abrahamit, mori familjen e tij ne Egjipt. Pas 400 vjeteve, pasardhesit e tij ishin rritur se tepermi ne numer. Ne kete kohe ne Egjipt vjen nje faraon i ri. Per shkak te frikes se tij ndaj numrin gjithnje e ne rritje te hebrenjve, ai vendosi ti skllaveroje ata.

Eksodi 1 dhe 2 na jep nje pasqyre te tere kesaj ngjarjeje, duke vazhduar me lindjen dhe rritjen e Moisiut. Populli kishte kohe qe i ishte drejtuar Perendise, per clirim, dhe Perendia ua dha kete clirim nepermjet Moisiut.

STUDIMI

Moisiu, drejtuesi

1. Lexo Hebrenjte 11 :23-29. Cili eshte mendimi juaj, perse Zoti zgjodhi Moisiun per udheheqje ?
2. Lexo Eksodin 3 dhe 4. Kur Perendia i shfaqti Moisiut planin qe Ai kishte per te, si mendoi Moisiu se populli do te rreagonte (Eksodi 3:18)
3. Vepra e kujt ishte ajo qe do te behej (Eksodi 3:17,20,21 dhe 4:12)
4. Vezhgoni dialogun e kapitullit 4 si pergjigjej Moisiu, dhe si reagonte Zoti (1-9, 10-12, 13-17)
5. Ne Eksodin 4 :1 Moisiu pyeti « po sikur populli te mos me besojë ».. Kur Moisiu ishte i respektueshem, si u pergjigj populli. (v31)

Pashka (Eksodi 12)

1. Perse Zoti ishte duke derguar plaget ne kete periu dhe? (Eksodi 12:12)
2. Cili ishte udhezimi jetesor i dhene bijve te Izraelit (v13)
3. Cila eshte lidhja midis vdekjes se Krishtit dhe Pashkes (Eks. 12:3 + Gjoni 1:29; Eks. 12:5-6 + Isaia 53:7 + 1 Pjetrit 2:22; Eks. 12:6 + 1 Korintasve 5:7)
4. Cfare mendoni se u ndodhi atyreve qe nuk ju binden udhezimit te Perendise? Cfare te vertete frymore kuptoni nepermjet ketij rasti ?
5. Si Eksodi 12 :29 ndikon ne gjendjen e nje personi qe akoma nuk e ka pranuar Krishtin ?

Eksodi (Dalja)

1. Nje nder ngjarjet me te rendesishme ne historine e Izraelit ishte menjehere pas Pashkes. Cila ishte ajo (Eksodi 12 :40-41)
2. Krahaso Eksodin 3 :7-8 dhe Gjonin 3 :16. Si i bashkangjisni ?
3. Nje nder mrekullite me te medha ne historine e njerezimit, eshte shenuar ne Eksodin 14. Cfare te vertete frymore ju zbulon juve kjo eksperience ?
4. Shiko Eksodin 17:1-7 ; 32:1-6, 15-20 ; Numrat 21 :4-9). Cfare vlere praktike zbuloni juve per veten tuaj nepermjet ketyre ngjarjeve ? (1 Korintasve 10:5-11). Rreshtoni mekatet dhe zakonet qe jane treguar neper keto shembuj.
5. Si perfundim nxirr nje ide kryesore se cfare Zoti na ka premtuar te gjithëve nepermjet 1 Korintasve 10 :1-13

APLIKIMI

- A. Perendia i beri Moisiut nje pyetje. Cila ishte ajo? (Eksodi 4:2)
- B. Zoti pret prej nesh te perdorim ate mjet qe poseidojme. Moisiu perdori nje shkop, Davidi nje llastik, Gedeoni, shtamba.. Cfare mjetesh posedoni juve ?
- C. Si mendoni se Perendia do te deshironte qe ne te perdornim mjetet qe ai na ka dhene ?
- D. Si mund te perdorni 1 Korintasve 10 :13 ne jeten tuaj te perdirshme ?